



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Tiranë, më 18.3.2024  
(Dokument Parlamentar)

**RAPORT**

(Për dhënie mendimi)

**PËR**

**“AKTIN NORMATIV Nr.1, DATË 21.2.2024 “PËR DISA NDRYSHIME NË  
LIGJIN NR.97/2023, “PËR BUXHETIN E VITIT 2024”**

➤ *Hyrje*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e datës 18.3.2024, mori në shqyrtim *Akti normativ Nr.2, 1, datë 21.22.2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i propozuar nga Këshilli i Ministrave.*

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në zbatim të nenit 29, pika 2, të Rregullores së Kuvendit caktoi relator për shqyrtimin e Aktit normativ deputin, z. Klevis Xhoxhi.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e aktit normativ ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave;

Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre e Financave,  
Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit,  
Z. Niko Lera, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Fiskale,  
Z. Endrit Lami, Drejtor i Përgjithshëm i Programimit Makroekonomik,  
Znj. Kesjana Halili, Drejtor i Përgjithshëm i Borxhit Publik,  
Znj. Xhoana Agolli, Drejtor i Drejtorise së Monitorimit të Buxhetit,  
z. Etugert Llazi, Drejtor i menaxhimit të Investimeve Publike.

➤ ***Baza kushtetuese e aktit normativ***

Akti Normativ nr.1, datë 14.12.2023 datë 21.22.2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenin 101 të Kushtetutës.

Neni 101 i Kushtetutës parashikon të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Sipas dispozitave kushtetuese, akti normativ me fuqinë e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin, është një instrument që mundëson përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit.

Bazuar në nenin 101 të Kushtetutës këto akte e humbasin fuqinë nëse nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve. Nga studimi i dokumentacionit shoqërues rezulton se Akti Normativ nr.1, datë 21.2.2024, (me dokumentacionin shoqërues), është depozituar në Kuvend nga Këshilli Ministrave më datë 22.2.2024, në këto kushte Kuvendi është brenda afateve kushtetuese për shqyrtimin dhe miratimin e këtij akti.

➤ ***Nevoja dhe urgjenca***

Nevoja për aktin normativ lidhet me rrethanat dhe situatën faktike pas vlerësimit vjetor të treguesve fiskalë 2023 të bërë nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshimeve të ndodhura në kabinetit qeveritar në janar 2024.

Rishikim i buxhetit të vitit 2024 ka për qëllim kryesor rishikimin e buxhetin vjetor të riorganizimit të ministrive të reja, sipas fushave të përgjegjësisë funksionale përkatëse. Kjo, krahas disa rishikimeve në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të cilat synojnë përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit vjetor 2024.

Rishikimi është i orientuar drejt rezultateve të pritshme të cilat garantojnë zbatueshmërinë e tij. Është thelbësore të theksohet se zhvillimet makrofiskale dhe buxhetore në mbylljen e vitit buxhetor 2023 karakterizoheshin nga përmirësime të ndjeshme të parametrave të konsoliduar. Këto përmirësime vazhduan trendin pozitiv në fillim të vitit 2024, krijuar besimin për vazhdimësinë e këtyre ritmeve gjatë pjesës tjetër të vitit 2024.

Urgjenca mbështetet në faktin se ndryshimet në buxhet duhet të miratoheshin e bëheshin efektive në një kohë sa më të shpejtë, për të siguruar mundësinë e përdorimit të fondeve buxhetore dhe vijimësinë e zbatimit të buxhetit nga strukturat e reja qeveritare.

Përkohshmëria mbështetet në faktin se akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë maksimale prej 45 ditësh, deri në datën e miratimit të tij nga Kuvendi.

Pra, Akti normativ nr. 1, datë 21.2.2024 plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.23, datë 16.4.2014 etj.

Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë :

- a) Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit
- b) Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit
- c) Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre
- ç) Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi

➤ ***Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ***

Qëllimi i aktit normative është ;

- reflektimin në buxhetin vjetor pas riorganizimit të ministrive të reja, sipas fushave të përgjegjësisë funksionale përkatëse,
- nevojën për disa rishikime në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të cilat synojnë përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2024,

Ndryshimet kryesore që parashikon akti normative janë;

**1. të ardhurat e përgjithshme të buxhetit rriten me 10.7 miliardë lekë;**

Kjo rritje mbështetet në performancën pozitive të këtyre të ardhurave gjatë vitit 2023 dhe muajit janar 2024, si dhe pritshmëritë për vazhdimin e trendit pozitiv deri në fund të këtij viti.

Rritja e të ardhurave jo tatimore me prej 7.9 miliardë lekësh që i korrespondon rezultatit të akumuluar financiar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të cilat janë parashikuar të derdhen në buxhetin për vitin 2024 si edhe rritjen me 2.8 miliardë lekë të nivelit të planifikuar të të ardhurave tatimore, në disa pika kyçe janë:

Të ardhurat e institutit të sigurimeve shoqërore janë rritur me 7.9 miliardë lekë gjatë vitit 2023, duke reflektuar një performancë të mirë në mbledhjen e kontributeve. Kjo rritje ka rezultuar në reduktimin e deficitit të skemës së pensioneve.

Deficiti i skemës së pensioneve është reduktuar në nivelin 0.8% të PBB, krahasuar me nivelin e tij prej rreth 2% të PBB në vitin 2013. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të

rritjes së të ardhurave dhe mbështetur në ligjin që lejon transferimin e rezultateve financiare pozitive në buxhetin e shtetit.

Ligji nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024" lejon transferimin e rezultateve pozitive në fund të vitit buxhetor në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin pasardhës, pas miratimit të pasqyrave financiare, por jo më vonë se muaji prill 2024. Kjo dispozitë mbështet përmirësimin e rezultatit financiar të institutit të sigurimeve shoqërore për të parashikuar të ardhurat e përgjithshme të buxhetit për vitin 2024.

Pra, si rezultat i performancës pozitive të të ardhurave të institutit të sigurimeve shoqërore, ka pasur një reduktim ndjeshëm të transfertës së buxhetit të shtetit për skemën e sigurimeve shoqërore. Kjo është një shenjë e mirëqenies financiare dhe ka ndikuar në shpenzimet totale të shtetit.

Trendi pozitiv i mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe rënia e transfertës së buxhetit të shtetit për këtë skemë pritet të vazhdojë edhe në vitin 2024. Kjo është parashikuar të ndikohet nga rritja e pagave në sektorin publik dhe privat.

Pra e gjithë kjo tregon një zhvillim pozitiv në performancën financiare të institutit të sigurimeve shoqërore dhe impaktin e kësaj në buxhetin e shtetit dhe skemën e pensioneve në Shqipëri.

**2. shpenzimet e përgjithshme të buxhetit rriten me 6.7 miliardë lekë si pasojë e ndryshimeve;**

Riorganizimi i Këshillit të Ministrave me vendimin respektiv nr.30 dhe nr.31, datë 17.1.2024, duke ndarë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe duke krijuar Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, e cila shoqërohet me ndryshime në buxhet duke reflektuar fushat e reja të përgjegjëse.

Sigurohet mbështetje për Ministrin e Ri të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, përmes plotësimit të organikës dhe fondet buxhetore të nevojshme për vitin 2024.

Mbështetje për Bizneset e Sektorit të Industrisë Përpunuese duke parashikuar përdorimin e instrumentit të garancisë shtetërore të huas për financimin e bankave të nivelit të dytë për të përmirësuar proceset teknologjike dhe konkurrueshmërinë në tregjet botërore.

Riklasifikimi i Projektit të Portit të Ri Tregtar - Porto Romano, Durrës, i cili riklasifikohet si investim me financim të brendshëm për të mundësuar përshejtimin e procedurave dhe avancimin e punimeve.

Financimi për Task-Forcën pranë AKUK do të siguroj financimi e structures së re të posaçme, Task-Forcën e ngritur pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, për trajtimin e ujërave të ndotura dhe mbrojtjen e infrastrukturës.

Financimi i Projektit për Konvikte në Arsimin e Mesëm Profesional do të bëjë të mundur përmirësimin e kushteve të konvikteve në arsimin e mesëm profesional në disa qarqe të Shqipërisë, përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Të gjitha këto ndryshime dhe investime tregojnë përpjekjet e qeverisë për të përmirësuar infrastrukturën, zhvillimin ekonomik, dhe sektorin e arsimit në Shqipëri gjatë vitit 2024.

**3. deficiti buxhetor reduktohet me 4 miliardë lekë;**

**4. borxhi publik pëson ndryshime;**

Reduktohet me 4 miliardë lekë financimi i huaja për projekte, që mund të ndikojë në përmbajtjen dhe realizimin e disa projekteve të planifikuara që mund të jenë në varësi të këtij financimi.

Rritja e Financimit me Kreditë e Huaja me rreth 5.5 miliardë lekë në mbështetje buxhetore nga një kredi me terma të buta nga KFW-ja për reformën në sektorin e energjisë, e cila nuk u disbursua gjatë vitit 2023.

Rritja e Stokut të Pritshëm të Garancive rritet me 4 miliardë lekë në fund të vitit 2024. Ky ndryshim reflekton mbështetjen e Këshillit të Ministrave për bizneset private në sektorin e industrisë përpunuese përmes garancive shtetërore të huas.

Pra ndryshimet e parashikuara në aktin normativ nr.1, datë datë 14.12.2023 datë 21.22.2024, “Për disa ndryshime në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, janë shumë të rëndësishme, pasi parashikon fondet buxhetore për vitin 2024 për strukturat e reja të kabinetit qeveritar, duke mundësuar funksionimin e tyre në përputhje me fushat respektive të përgjegjësisë.

Krahas kësaj, akti normativ mundëson edhe disa rialokime në zërat e të ardhurave, shpenzimeve, deficitit buxhetor dhe borxhit publik, të cilat mundësojnë zbatimin më të plotë të buxhetit të vitit 2024.

Ndryshimet e propozuara në Aktin normativ ruajnë trendin rënës të deficitit buxhetor dhe borxhit publik në raport me PBB, duke qenë në përputhje me rregullin fiskal të parashikuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor. Kjo politikë mundëson vijimin e konsolidimit fiskal, forcimin e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, si dhe të stabilitetit makroekonomik e fiskal të vendit.

➤ ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Akt normativ nuk synon përafrim me ndonjë legjislacion të Bashkimit Evropian.

➤ ***Institucionet zbatuese***

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohen Ministria e Financave.

➤ ***Efektet financiare***

Akt normativ ka efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit, për shkak të riorganizimit të kabinetit qeveritar .

➤ ***Çështje të diskutuara në komision***

Në mbledhjen e Komisionit, Kryetarja znj. Klotilda Bushka pasi theksoi se Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton këtë akt normative në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, ftoi znj. Adela Xhemali bëj prezantim të aktit, e cila në fjalën e saj argumentoi nevojën e rishikimit të buxhetit, duke parashtruar se qëllimi primar ishte reflektimi në buxhetin vjetor i riorganizimit të ministrive të reja, sipas fushave të përgjegjesisë funksionale përkatëse, si dhe nevoja për disa rishikime në zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, të cilat synojnë përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2024.

Znj. Xhemali detajoi më tej se rishikimi parashikon: reflektimin në të ardhurat e përgjithshme të tepricës prej 7.9 miliardë lekësh që i korrespondon rezultatit të akumuluar financiar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si edhe rritjen me 2.8 miliardë lekë të nivelit të planifikuar të të ardhurave tatimore; rritjen me 6.7 miliardë lekë të shpenzimeve buxhetore; reduktimin me 4 miliardë lekë të deficitit buxhetor; si dhe rritjen me 4 miliardë lekë të stokut të pritshëm të garancive në fund të vitit 2024, në kuadër të politikës së qeverisë për mbështetjen me garanci shtetërore të huas për bizneset private në sektorin e industrisë përpunuese.

Deputeti z. Klevis Xhoxhi, në cilësinë e relatorit detajoi ndryshimet e parashikuara në buxhetin e vitit 2024, në rialokimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, reduktimin me 4 mld lekë të deficitit, si dhe argumentoi nevojën dhe urgjencën e sjelljes të Aktit Normativ, vlerësoi kushtetutshmërinë dhe ftoi kolegët ta miratojnë.

Në përfundim të pyetjeve dhe diskutimeve, Kryetarja e Komisionit znj. Klotilda Bushka shprehu mbështetjen e saj të dhe ftoi anëtarët e Komisionit për të votuar aktin normativ.

➤ ***Përfundim***

Në përfundim të shqyrtimit të këtij akti normativ, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- Në aspektin ligjor, akti normativ i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, aktinormativ është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- Në përfundim, Komisioni pasi e shqyrtoi aktin normativ nr.1, datë 21.2.2024 dhe e miratoi atë me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për ta përcjellë mendimin Komisionit Përgjegjës dhe për votim në seancë plenare.

**RELATORI**

**Klevis XHOXHI**

**KRYETARI**

**Klotilda BUSHKA**